



Periodiku AMF

Mbi raportimin në Komisionin e Ekonomisë së Kuvendit të Shqipërisë, të Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2009

Kryetarja e Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, raportoi pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, më datë 13 prill 2010, mbi aktivitetin e institucionit dhe zhvillimet e tregjeve financiare jo-bankare, gjatë vitit 2009.

Vijon në faqen 2

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Mbiqëqyrjes të Sigurimeve, Maqedoni, në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve

Në datën 19 prill, 2009, në ambientet e Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare, u zhvillua Ceremonia e Nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare (AMF) dhe Agjencisë së Mbiqëqyrjes të Sigurimeve, Maqedoni (ISA) në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve.

Vijon në faqen 3

**Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura
Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-mars 2010**

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-mars 2010 arritën shifrën 2,071,568 mijë lekë, përkundëjt 1,944,005 mijë lekë të realizuara në janar-mars 2009 ose 6.56% më shumë.

Vijon në faqen 4

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2010

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2010 u dominua në masën 72.43% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 27.57% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Vijon në faqen 6

Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për periudhën janar-mars 2010

Tregu i pensioneve vullnetare, pavarësisht rritjes së

kontributeve dhe numrit të anëtarëve për periudhën janar-mars 2010, vazhdon të mbetet ende një treg i vogël, i cili pritet të zhvillohet pas ndryshimeve të fundit ligjore.

Vijon në faqen 7

**Ngjarje dhe zhvillime të tjera
Zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare mbi kuadrin rregullator financiar dhe politikat monetare**

Instituti për Stabilitet Financiar (BIS) në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (IMF) zhvilluan në Washington, në datë 23 prill, Konferencën Ndërkombëtare mbi kuadrin rregullator financiar.

Vijon në faqen 8

Zhvillohet aktiviteti 2 javor mbi zhvillimet dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë

Komisioni i Letrave me Vlerë (SEC) në USA, zhvilloi gjatë periudhës 19-29 prill 2010, në selinë qendrore të Komisionit në Washington DC, aktivitetin 2 javor lidhur me zhvillimet dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë.

Vijon në faqen 9

Zhvillohet takimi i këshillit të tregtisë së mallrave në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT)

Organizata Botërore e Tregtisë zhvilloi gjatë periudhës 28-30 prill 2010, në Gjenevë, takimin e këshillit të tregtisë së mallrave

Vijon në faqen 10

**Edukimi i konsumatorit
Kriza financiare dhe sistemet e pensioneve të detyrueshme në vendet në zhvillim**

(Material i marrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore, prill 2010)

Përgjigjet afatshkurtra dhe afatgjata për sistemet e pensioneve të pleqërisë

Kriza financiare botërore e ka prekur rëndë vlerën e asetëve të fondeve të pensioneve në mbarë botën. Rënia ekonomike globale do të ushtrojë trysni edhe mbi skemat publike të pensioneve të financuara sipas formës "PAYG" (pay as you go), duke kufizuar, në të njëjtën kohë, kapacitetin e qeverive për t'i zbutur të dy këto efekte. Qeveritë po reagojnë ndaj këtyre zhvillimeve në mënyra të ndryshme.

Vijon në faqen 11

Në këtë numër:

Mbi raportimin në Komisionin e Ekonomisë së Kuvendit të Shqipërisë, të Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2009

2

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Mbiqëqyrjes të Sigurimeve, Maqedoni, në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve

3

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

4

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

8

Edukimi i konsumatorit

11

Mbi raportimin në Komisionin e Ekonomisë së Kuvendit të Shqipërisë, të Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, për veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2009



Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, gjatë raportimit në Kuvendin e Shqipërisë

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, raportoi pranë Komisionit të Ekonomisë, në Kuvendin e Shqipërisë, më datë 13 prill 2010, mbi aktivitetin e institucionit dhe zhvillimet e tregjeve financiare jo-bankare, gjatë vitit 2009.

Në fjalën e saj, Zj. Gjoni bëri një përmbledhje të veprimtarisë, përpjekjeve, arritjeve dhe sfidave me të cilat AMF përballet në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri.

Në raportim u paraqit edhe ecuria e tregjeve financiare jo-bankare gjatë vitit 2009, roli aktiv i AMF në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe publikut në tërësi, si dhe masat e marra në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes së tregjeve nën juridiksionin e AMF.

Viti 2009 ishte një vit me zhvillime të rëndësishme në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes

dhe konsolidimit të legjislacionit rregullues të tregjeve financiare jo-bankare. Ky vit rezultoi me zhvillimi të reja në sigurime, me miratimin e 5 ligjeve të reja e një sërë aktesh nënligjore, me një sërë produktesh të teknologjisë e informacionit, si qendra e të dhënave të dëmeve motorike krahas asaj të shitjes e raportimit në kohë reale të policave motorike, me përgatitjen dhe licencimin e profesionistëve e ndërmjetësve të ndryshëm financiarë, me zhvillimin e koncepteve të reja të mbikëqyrjes financiare, me kontributin në plotësimin e pyetësorit e dokumenteve të MSA-së, me numrin jeshil në ndihmë të konsumatorit, me nënshkrim të dy MoU-ve mjaft të rëndësishme: ajo multilaterale e IOSCO-s (Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Letrave me Vlerë) si dhe me FMA-në (Autoriteti Rregullator Mbikëqyrës i Austrisë) për fushën e sigurimeve, etj.

Gjatë vitit 2009, tregu i sigurimeve pati vëmendjen kryesore dhe fokusimin e pjesës më të madhe të burimeve dhe kapaciteteve të AMF-së, duke qenë se mban peshën kryesore në tregun financiar jo-bankar në Shqipëri. Raporti i plotë i veprimtarisë, iu vu në dispozicion anëtarëve të Komisionit, të cilët vlerësuan pozitivisht punën e institucionit dhe bënë pyetje e komente të ndryshme në lidhje me zhvillimet në tregjet e mbikëqyrura dhe veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2009.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes të Sigurimeve, Maqedoni, në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve

Në datën 19 prill, 2009, në ambientet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u zhvillua Ceremonia e Nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes të Sigurimeve, Maqedoni (ISA) në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve.

Nënshkrimi i memorandumit shërben si bazë bashkëpunimi midis dy institucioneve



Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, gjatë nënshkrimit të memorandumit

rregullatore, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve, duke promovuar integritetin, stabilitetin dhe efikasitetin e industrisë së sigurimeve, si dhe duke siguruar një strukturë bashkëpunimi, e cila do të mundësojë rritjen e mirëkuptimit reciprok dhe shkëmbimin e informacionit brenda kuadrit rregullativ të dy vendeve.

Në fjalën e saj, Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së, vlerësoi bashkëpunimin dhe rëndësinë e nënshkrimit të marrëveshjes në lehtësimin dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së sigurimeve në të dy vendet. Z. Klime Poposki, President i Këshillit të Ekspertëve të ISA-së, në fjalën e tij vlerësoi nënshkrimin e marrëveshjes, sidomos kjo në kushtet aktuale të futjes dhe fuqizimit të shoqërive të sigurimit shqiptare që operojnë në tregun e Maqedonisë.

Në ceremoni ishin të pranishëm përfaqësues nga

autoritetet rregullatore të të dy vendeve, përfaqësuesi i lartë i Ambasadës së Maqedonisë

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-mars 2010


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-mars 2010 arritën shifrën 2,071,568 mijë lekë, përkundrejt 1,944,005 mijë lekë të realizuara në janar-mars 2009 ose 6.56% më shumë. Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 55.76% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 44.24% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme, primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 18.17% të sigurimeve të Jetës dhe 6.31% të sigurimeve të Jo-Jetës. 91.84% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës dhe 8.16% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës.

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2010 u nënshkruan rreth 135,080 kontrata sigurimi, ose rreth 16.09% më pak se në janar-mars të vitit 2009.


Sigurimet e detyrueshme

Gjatë janar-marsit 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 44.24% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-mars 2010



Struktura e tregut të sigurimeve, janar-mars 2010



Volumi i primit të shkruar bruto, janar-mars (2009-2010)


Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
Mars		
A) Sigurim i Jetës	143,129	169,135
B) Sigurim i Jo-Jetës	1,789,473	1,902,432
a) Sigurimi i Detyrueshëm	1,023,625	916,563
b) Sigurimi Vullnetar	777,251	985,869
c) Risigurimi	11,403	-
TOTAL	1,944,005	2,071,568

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për 3-mujorin 2010, arritën 679,070 mijë lekë, ose 1.59% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Në janar-mars 2010, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 183,862 mijë lekë, ose rreth 41.32% më pak se në janar-shkurt 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-marsit 2010 arritën në 53,631mijë lekë, apo 28.16% më shumë se në janar-mars 2009.

Volumi i primit të shkruar bruto, janar-mars 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet vullnetare

Në janar-mars 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,155,005 mijë lekë, ose 25.49% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 985,869 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 33.16% të pasuara nga, sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 30.53% dhe nga sigurimi kasko me 15.22%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-mars 2010, arritën në 82,338 mijë lekë, 5.56% më pak se në janar-mars 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 69.54% të të ardhurave të këtij grupi. Primet në sigurimet e jetës në janar-mars 2010 arritën në rreth 169,135 mijë lekë, ose rreth 18.17% më shumë se në janar-mars 2009. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.


Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbani, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 31.36% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 55.26% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-mars 2010 kapi vlerën 466,879 mijë lekë, ose 40.88% më shumë se në janar-mars 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit të detyrueshëm me 287,082 mijë lekë, apo 63.47% të totalit.



Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2010

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2010 u dominua në

masën 72.43% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 27.57% nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 97.19 % e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - mars 2010, flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”, përkatësisht me 56.92% dhe 23.86% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 97.24% të të gjitha transaksioneve në këtë treg, në raport me personat juridikë.


Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-mars 2010 ka pasur një rritje prej 1,011 milionë lekë ose në masën 40.17%, krahasuar me vitin 2009, shoqëruar me një rritje në masën 4.97% të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit C “Blerje nga individët para

afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-mars ka pasur një rritje prej 496 milionë lekë ose 252.72%, krahasuar me vitin 2009, ndjekur nga një rritje në masën 166.67% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me vitin 2009, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 1,507 milionë lekë.



Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë 2009, 2010

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mijë lekë)		Ndryshimi (në %)
	2009	2010	
Periudha janar - mars	2009	2010	'01/'09-1
Letra me Vlerë të Qeverisë			
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	2,516.83	3,527.92	40.17
Individë	2,397.21	2,329.37	(2.09)
Persona juridike	137.63	1,198.55	770.85
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	196.26	692.25	252.72
Individë	194.36	332.34	70.99
Persona juridike	1.89	359.919	1,8942.70

Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për periudhën janar-mars 2010

Tregu i pensioneve vullnetare, pavarësisht rritjes së kontributeve dhe numrit të anëtarëve për periudhën janar - mars 2010, vazhdon të mbetet ende një treg i vogël, i cili pritet të zhvillohet pas ndryshimeve të fundit ligjore. Rritja e vlerës së kontributeve dhe numrit të anëtarëve, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009, është përkatësisht në masën 42.20% dhe 14.93%, ndërsa po të krahasohet me 31.12.2009 kjo rritje është përkatësisht në masën 11.2% dhe 1.3%.

Më poshtë pasqyrohen disa të dhëna mbi tregun e pensioneve vullnetare private:

Tregu i Pensioneve Private Vullnetare viti 2009, 2010 (kontribute)

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Periudha janar - mars			'10/'09-1		
Raiffeisen PENSIONS	34,995,771	41,976,702	19.95	61.33	51.73
Capital	9,949,100	24,688,278	148.15	17.44	30.43
Sigma IPP	12,117,362	14,474,862	19.46	21.24	17.84
Total	57,062,233	81,139,842	42.20	100.00	100.00

Tregu i Pensioneve Private Vullnetare viti 2009, 2010 (kontribues)

Shoqëria	Numri kontribuesve		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Periudha janar - mars			'10/'09-1		
Raiffeisen PENSIONS	1,667	1,639	(1.68)	42.70	36.53
Capital	1,559	1,853	18.86	39.93	41.30
Sigma IPP	678	995	46.76	17.37	22.18
Total	3,904	4,487	14.93	100.00	100.00

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare mbi kuadrin rregullator financiar dhe politikat monetare

Instituti për Stabilitet Financiar (BIS) në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (IMF) zhvilluan në Washington, në datë 23 prill, Konferencën Ndërkombëtare mbi kuadrin rregullator financiar.

Në këtë Konferencë morën pjesë personalitete nga bota financiare, guvernatorë nga banka qendrore, drejtues të autoriteteve mbikëqyrëse homologe financiare, si dhe politikanë dhe ekspertë akademikë nga mbarë bota.

Qëllimi i kësaj Konference ishte të diskutonte të gjitha rrugët e mundshme për t'i zbatuar në praktikë politikat e fundit të promovuara dhe për propozime të reja për të ndihmuar stabilizimin e sistemit financiar.

Katër panelet e Konferencës përfshinin çështjet e mëposhtme:

1-Politikat dhe reformat e kujdesshme sektoriale

Në këtë panel u diskutua mbi krizën globale financiare, e cila zbuloi që rregullat ekzistuese dhe zbatimi i tyre kanë nevojë të përmirësohen në mënyrë që sistemet financiare të jenë të fuqishme. Reformat rregullatore të kujdesit sektorial kanë avancuar dhe janë përqendruar në propozime që synojnë në fuqizimin e cilësisë, sasisë dhe mjaftueshmërisë së kapitalit bankar, lidhjen e kapitalit të kërkuar me riskun, fuqizimin e qeverisjes, menaxhimin e riskut dhe mbikëqyrjes, si dhe paraqitjen e kërkesave për zbutjen e likuiditeteve. Në të njëjtën kohë i duhet kushtuar më shumë vëmendje dhe shtimit të përmirësimit të rregullave, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mbikëqyrjes në mënyrë

që rregullat të jenë efektive, në kohë dhe të vazhdueshme.

Çështjet që u diskutuan në këtë panel synonin të zbulonin: *cili është objektivi kryesor i reformave të ndërmarra; sa është mundësia e suksesit të tyre në reduktimin e probabilitetit të krizave; efektet e Bazel II mbi kapitalin dhe masat mbi likuiditetin; cilat janë elementet kyç në një zbatim efektiv të reformave në vende të ndryshme; si dhe si mund të përmirësohet cilësia e mbikëqyrjes dhe disiplinimi i tregut mbështetur tek Bazel II, shtylla 2 e shtylla 3 për kuadrin rregullator të kapitalit.*

2- Mbikëqyrja me 'fokus- makro'

Ekzaminimet më të fundit të krizës nxorën përfundimin, se duhen kompletuar metodat tradicionale të politikave dhe reformave me 'mikro-fokus' me një përjasje të mbikëqyrjes me 'makro-fokus'.

Në panelin e 2-të, çështjet më kryesore që u diskutuan ishin: Mjetet dhe përdorimi i përjasjes dhe metodave të mbikëqyrjes me 'makro-fokus' në praktikë, në mënyrë të dobishme për zbulimin e riskut sistematik; rrugët e mundshme për zbatimin e instrumenteve rregullatore mbrojtës, cila është rruga më efektive për institucionet financiare që vlerësojnë riskun dhe cili është matësi më i mirë e i duhur i rregullimit dhe mbikëqyrjes. U diskutua shumë mbi rolin e një mbikëqyrje gjithëpërfshirëse dhe cili duhet të jetë roli i bankave qendrore mbi riskun sistematik në përcaktimin e politikave rregullatore makro dhe më e rëndësishmja çfarë niveli koordinimi duhet të kenë mbikëqyrësit dhe bankierët e bankave qendrore në zbatimin e kuadrit rregullator makro.

3-Politikat monetare dhe stabiliteti financiar

Të gjithë autoritetet monetare dhe mbikëqyrëse duhet të kenë një kujdes të madh në zhvillimin e sektorëve financiarë, riskun dhe dobësitë e tij në të kaluarën. Pikëpamjet ndryshojnë mbi indikatorët e stabilitetit financiar, si dhe në aftësinë mbi politikat e normës së interesit për rritjen e fuqizimin e stabilitetit financiar por



pavarësisht nga kjo, duhet një menaxhim i përbashkët i politikave të kredibilitetit dhe mundësive të ndërsjella me objektiva politike të tjera.

Për arritjen e këtyre objektivave u propozuan: krijimi i kuadrit rregullator për politikën monetare, dhënia e mandatit bankave qendrore, në mënyrë që të kenë rol të qartë në stabilitetin financiar, rritja e rolit të qeverisjes dhe koordinimi i politikave makro në rang ndërkombëtar, me synim forcimin e sistemit financiar.

4- Aspekte ndërkufitare të rregullimit dhe mbikëqyrjes

Mbikëqyrja ndërkufitare ka qenë në qendër të vëmendjes së diskutimeve, e parë kjo në dritën e diskutimeve të Basel II. Është vlerësuar progresi i bërë nga institucionet mbikëqyrëse. Në momentet e krizës, këto çështje janë shumë të rëndësishme në veprimet strukturore ndërkombëtare. Roli i mbikëqyrjes së institucioneve të vendit dhe të huaja në vend, është shumë i rëndësishëm. Disa dështime të konstatuara kanë sjellë vazhdimësitë në mbikëqyrjen dhe rregullimin e degëve, si dhe bëjnë thirrje për rritje të vëmendjes, sidomos në rastet ku institucionet financiare janë shumë të mëdha dhe të fuqishme, në krahasim me autoritetin mbikëqyrës të vendit, duke krijuar kështu një paqartësi e mungesë kontrolli në kufi.

Çështjet që u diskutuan në këtë panel nënvizuan se: *me gjithë interesat e ndryshme që kanë, duhet një bashkërendim i punës së autoritetit mbikëqyrës vendas me autoritetin homolog të vendit të institucionit financiar që operon në atë vend.* Rritja e veprimeve ndërkombëtare financiare kërkon angazhimin e autoriteteve mbikëqyrëse financiare në çështjet kufitare dhe kujdes në përcaktimin e principeve që duhet të drejtojnë adoptimin e rregullimeve të kujdesshme për çështjet kufitare, si dhe përcaktimin e elementeve kyç të mbikëqyrjes dhe rregullimit, të cilët do të lehtësojnë një zgjidhje efektive të rëndësishme së kontrollit sistematik të

institucioneve financiare.

Në përfundim të Konferencës, u diskutuan çështje të rëndësishme të politikave dhe reformave të Bankave Qendrore dhe Autoriteteve Mbikëqyrëse, për të zbutur krizën dhe për të arritur një rregullim dhe mbikëqyrje efektive të sistemit financiar në tërësi.

Zhvillohet aktiviteti 2 javor mbi zhvillimet dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë

Komisioni i Letrave me Vlerë (SEC) në USA, zhvilloi gjatë periudhës 19-29 prill 2010, në selinë qendrore të Komisionit në Washington DC, aktivitetin 2 javor lidhur me zhvillimet dhe mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë.

Aktiviteti përkoi dhe me 20-vjetorin e krijimit të Institutit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Tregut të Letrave me Vlerë.

Çështjet që u trajtuan përfshinin krizën financiare, skemat piramidale, manipulimin e tregjeve, ekzaminimin e brokerave dhe këshilltarëve të investimit, mbikëqyrjen e shkëmbimeve valutore, zgjidhjet optimale për shkeljet, si dhe teknikat e hetimit.

Gjatë aktivitetit u trajtuan raste të ndryshme hetimi nga Komisioni, si dhe roli i bashkëpunimit ndërkombëtar me rregullatorët në suksesin e hetimit dhe zbatimit të ligjit. Theks i veçantë iu vu nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve dhe rolit të IOSCO-s. Një seminar i veçantë, realizuar nga departamenti i zbatueshmërisë, solli një bashkëpunim aktiv ndërmjet pjesëmarrësve dhe punonjësve të Komisionit, lidhur me mënyrën e hetimit të një skeme hipotetike të mashtrimit në fushën e letrave me vlerë.

Temat e diskutuara ndihmojnë jo vetëm në zhvillimin e tregjeve por dhe në forcimin e rolit të rregullatorëve. Programi i aktivitetit dha mundësinë dhe krijoi lidhje ndërmjet rregullatorëve për të mbrojtur, si tregjet ashtu

dhe investitorët. Aktiviteti ndihmoi në rritjen dhe bashkëveprimin e rregullatorëve nga e gjithë bota me punonjësit e Komisionit të letrave me Vlerë në USA, për të ndarë praktikat më të mira që kanë të bëjnë me rastet e manipulimeve, pastrimit të parave apo çështje të tjera të zbatueshmërisë, si dhe çështjet e zhvillimit të tregjeve si qeverisja e korporatave, inspektimeve, etj.

Zhvillohet takimi i këshillit të tregtisë së mallrave në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT)

Organizata Botërore e Tregtisë zhvilloi gjatë periudhës 28-30 prill 2010, në Gjenevë, takimin e këshillit të tregtisë së mallrave, ku u shqyrtua mbi raportin e politikave të tregtisë (Trade Policy Review) që prej anëtarësimit të Shqipërisë në OBT deri më sot. Ky ishte rishikimi i parë që bëhej pas anëtarësimit të Shqipërisë, që prej vitit 2000.

Sipas procedurave të OBT-së, draft-raporti i sekretariatit të OBT-së dhe Deklarata e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë iu ishin shpërndarë të gjithë anëtarëve të OBT-së, të cilët deri në datën 10 prill 2010, mund të paraqitnin me shkrim pyetje të ndryshme ndaj dy materialeve, të cilave Shqipëria duhej t'i përgjigjej.

Në raport u vu në dukje progresi i bërë nga momenti i anëtarësimit të Shqipërisë në OBT deri në vitin 2010. Raporti dha një panoramë të përgjithshme të treguesve makroekonomike të vendit. U vunë në dukje reformat e ndërmarra për krijimin e një klime të favorshme për biznesin, për liberalizimin e tregjeve dhe zhvillimin e konkurrencës.

Në këtë seancë delegacionit shqiptar iu shpërndanë pyetjet me shkrim që ishin paraqitur nga shtete të ndryshme. ("Advance Written Questions").

Pas prezantimit të raportit të delegacionit shqiptar, përfaqësuesi i Hungarisë, bëri një

deklaratë përmbledhëse të raportit të përgatitur nga Sekretariati i OBT-së për Shqipërinë. Ambasadori hungarez, në deklaratën e tij, vuri në dukje progresin e Shqipërisë në 10-vjetorin e anëtarësimit në OBT, si dhe u përgëzoi Shqipërinë si një vend anëtar i OBT-së që kishte respektuar detyrimet dhe angazhimet në këtë organizatë. Gjithashtu, në deklaratën e tij, Ambasadori hungarez bëri komente dhe nënvizoi disa çështje për të cilat drejtoi dhe pyetje për delegacionin shqiptar.

Të gjithë diskutantët përshëndetën Shqipërinë dhe delegacionin shqiptar për punën serioze të bërë dhe përgatitjen e përgjigjeve në një kohë shume të shpejtë, për progresin e bërë në këto vite dhe për arritjen e një stabiliteti ekonomik, pavarësisht krizës botërore, duke i uruar suksese delegacionit shqiptar në kuadrin e rishikimit të marrëveshjes së tregtisë me OBT. Në të njëjtën kohë, disa nga diskutantët paraqitën edhe pyetje shtesë në adresë të delegacionit shqiptar.

Pjesëmarrja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare kishte të bënte me zbatimin e detyrimeve dhe angazhimeve që Shqipëria ka ndaj Organizatës Botërore të Tregtisë edhe në fushat e tregut financiar jo-bankar, fusha, të cilat licencohen, rregullohen dhe mbikëqyren nga ky institucion. Nga ana e OBT ishte parashikuar që brenda vitit 2009 Shqipëria të përgatiste dhe të paraqiste pranë OBT një raport periodik për vlerësimin e politikave tregtare nga momenti i anëtarësimit. Në këtë kuadër edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare paraqiti raportin e tij duke bërë një prezantim të zhvillimeve legislative, në kuadrin e plotësimit të angazhimeve që burojnë nga anëtarësimi në këtë organizatë.

Në përfundim të diskutimeve, Kryetari i seancës, bëri një përmbledhje të takimit për rishikimin e marrëveshjes së politikave tregtare, duke e konsideruar këtë proces si të suksesshëm.

Edukimi i konsumatorit

Kriza financiare dhe sistemet e pensioneve të detyrueshme në vendet në zhvillim

(Material i marrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore, prill 2010)

Përgjigjet afatshkurtra dhe afatgjata për sistemet e pensioneve të pleqërisë

Kriza financiare botërore e ka prekur rëndë vlerën e aseteve të fondeve të pensioneve në mbarë botën. Rënia ekonomike globale do të ushtrojë trysni edhe mbi skemat publike të pensioneve të financuara sipas formës “PAYG” (pay as you go), duke kufizuar, në të njëjtën kohë, kapacitetin e qeverive për t'i zbutur të dy këto efekte. Qeveritë po reagojnë ndaj këtyre zhvillimeve në mënyra të ndryshme. Disa po pyesin nëse duhet rimenduar apo jo drejtpeshimi midis skemave të pensioneve me kontribute të përcaktuara dhe atyre jo të mbuluara me fonde. Disa madje kanë filluar të veprojnë për t'i kthyer mbrapsht reformat e mëparshme.

Në këtë material trajtohen efektet e mundshme të krizës financiare mbi sistemet tërësisht të mbuluara me fonde dhe që funksionojnë sipas parimit “PAYG” në vendet kliente të Bankës Botërore dhe identifikohen përgjigjet afatshkurtra dhe afatgjata përmes politikave. Në material nuk shikohen në thellësi çështjet e identifikuar. Më pas do të përgatiten materiale teknike të veçanta. Edhe ky material do të përditësohet dhe përmirësohet me lindjen e problemeve të reja.

Mesazhet kryesore që sjell ky material mund të përmbledhen, si vijon:

Është mirë të evitohen ndryshimet e papritura të politikave në përgjigje të rrethanave të menjëhershme.

Sistemet e pensioneve janë strukturuar të funksionojnë në periudha të gjata kohore. Përgjigjet afatshkurtra të përgatitura dobët, ndaj

ngjarjeve relativisht të rralla, mund të kenë pasoja afatgjata negative për kapacitetin e sistemeve të pensioneve për të siguruar nivele adekuate të ardhurash për pensionistët.

Është e rëndësishme të vërehet se vetëm një numër i vogël pensionistësh preken nga kriza.

Mund të shikohet mundësia e masave të synuara për zbutjen e humbjeve në kursimet e tyre dhe vlerën e pensioneve të tyre.

Kriza e tanishme e forcon nevojën për sisteme pensionesh të diversifikuara me disa shtylla.

Këto mundësojnë një diversifikim më të mirë të rreziqeve dhe, kështu, ofrojnë një mbrojtje më të mirë për personat që mund të ndodhen në pozita të pambrojtura nga ai lloj i tronditjeve ekonomike që po shohim tani.

Duhet treguar vëmendje gjithnjë e më e madhe ndaj menaxhimit të zbulimit të personave ndaj risqeve financiare afatshkurtra në sistemet e mbuluara me fonde.

Forcimi i menaxhimit të zbulimit mund të arrihet përmes portofoleve tip të strukturuar për punonjës të cilët janë duke iu afruar moshës së daljes në pension, si edhe përmes zhvillimit të kalimit me faza drejt ofrimit të pagesave të cilat e kufizojnë efektin e luhatjeve financiare afatshkurtra.

Efekti i krizës financiare te pensionet me kontribute të përcaktuara të mbuluara me fonde

Efekti i krizës financiare te individët që marrin pjesë në skemat me kontribute të përcaktuara të mbuluara me fonde varet nga katër faktorë kryesorë: (i) ndryshimet e çmimeve të aseteve dhe rikuperimi i mundshëm në periudhën afatshkurter; (ii) pjesa e pasurisë së pensioneve që mbështetet nga asetet e llogarive individuale të mbuluara me fonde; (iii) prania e pensioneve sociale minimale apo garancive që janë përfshirë në sistemin e pensioneve; si dhe (iv) kërkesa dhe kuadri për llogaritjen vjetore të detyrueshme të tepricës së akumuluar në momentin e daljes në pension.

Humbjet në vlerat e aseteve gjatë 12 muajve të fundit të raportuara nga fondet e pensioneve kanë qenë të konsiderueshme. Në vendet kliente me sisteme të mbuluara me fonde, këto humbje shkojnë nga 8% deri në 50%. Edhe pse këto humbje janë shqetësuese në periudhën afatshkurtër për pjesëmarrësit në skema, ato nuk duhen marrë si një tregues i performancës së përgjithshme afatgjatë të fondeve, e cila është perspektiva e rëndësishme për çdo sistem pensionesh. Madje, nga viti 1994 deri në fund të vitit 2007, në 13 vende për të cilat ka të dhëna, fondet e pensioneve të detyrueshme patën një normë vjetore reale kthimi 6% në vit. Për shembull, në Kili, edhe duke i përfshirë humbjet e vëna re deri në gusht të këtij viti, kthimet reale për periudhën 2002-2008 shkonin nga 3% deri në 10% në vit, në varësi të llojit të portofolit (AFP, 2008).

Shumica e vendeve me pensione të mbuluara me fonde të detyrueshme kanë sisteme me disa shtylla në të cilat llogaritë individuale të mbuluara me fonde përbëjnë vetëm një pjesë të paketës së përgjithshme të pensionit të pleqërisë. Në shumicën e vendeve, individët në pension marrin edhe një komponent me përfitime të përcaktuara dhe shpesh ka pension minimal të garantuar. Të gjitha vendet në Evropën Lindore/Azinë Qendrore (EAQ), me përjashtim të Kazakistanit, të cilat futën skema të mbuluara me fonde, mbajtën edhe sistemin me përfitime të përcaktuara. Për shembull, në Lituani dhe Hungari, sot nga asetet financiare në llogari individuale vjen më pak se 30% e paketës së përfitimeve të pensionit për pensionistët.

Sistemet e të ardhurave për individët në moshë pensioni, të cilat janë më të zbuluara ndaj krizës financiare përfshijnë ato të Kilit, Salvadorit, Meksikës dhe Perusë, ku janë hequr sistemet me përfitime të përcaktuara dhe ku shumica e të ardhurave do të vijnë nga pensionet me kontribute të përcaktuara të mbuluara me fonde. Mirëpo, në Meksikë, qeveria ka garantuar që të gjitha pensionet nën sistemin e ri do të ishin të

paktën sa pensionet në skemën e mëparshme “PAYG” për personat e përfshirë që më parë në mbulim. Efekti i zvogëlimit të vlerave të aseteve në Meksikë, për rrjedhim, do të kompensohet për personat të cilët dalin në pension përpara rikuperimit të vlerave të aseteve.

Shumica e vendeve japin edhe pensione sociale apo pensione minimale të garantuara. Objektivi kryesor i këtyre masave është parandalimi i varfërisë në moshë të madhe. Ato bëjnë pjesë në sistemet me kontribute dhe pa kontribute (shtylla zero). Vlera mesatare e këtyre përfitimeve në të gjitha vendet për të cilat ka informacion është rreth 30% e të ardhurave mesatare të ekonomisë. Si rezultat, edhe aty ku pensionet janë shumë të zbuluara ndaj luhatjeve të vlerës së aseteve financiare, në shumë raste pensionet minimale të garantuara i mbrojnë nga varfëria punonjësit me të ardhura të ulëta. Sigurisht, rënia e çmimeve të aseteve mund të vazhdojë t'i ulë ndjeshëm pensionet.

Vetëm një numër i vogël punonjësish do të dalin në pension gjatë periudhës kur pensionet e tyre do të zvogëlohen për shkak të rënies së vlerave të aseteve. Punonjësit që përballesh me rënien më të fundit të pensioneve të tyre janë ata të cilëve u duhet të dalin në pension në mes të krizës dhe, në veçanti, ata të cilëve u është dhënë leja t'i transformojnë kursimet e tyre për pension në shumë vjetore. Shumica e vendeve me sisteme pensionesh të detyrueshme të mbuluara me fonde kanë sisteme të krijuara gjatë njëzetë viteve të fundit dhe, zakonisht, përfshijnë vetëm punonjës të cilët kishin më shumë se 20 vjet nga moshë normale e daljes në pension. Megjithatë disa i kanë lejuar punonjësit me moshë më të madhe të kalojnë në sistemin e mbuluar me fonde, me përjashtim të disa vendeve, normat për punonjësit në moshë më të madhe nuk kanë qenë shumë të larta. Rrjedhimisht, ka relativisht shumë pak individë që mbështeten shumë në një llogari të mbuluar me fonde të cilët do të dalin në pension në periudhën afatshkurtër.

Situata ndryshon nga rajoni në rajon. Në vendet në Evropën Lindore dhe Qendrore dhe në Azi (EAQ) që i kanë reformuar sistemet e tyre në fillim të viteve '90, ata që e kanë mbushur moshën e pensionit do të dalin në pension pas 15 ose më shumë vjetësh dhe ata që do të dalin në pension pa e mbushur moshën pas 4 vjetësh. Në Amerikën Latine, ku reformat janë bërë më përpara, ndryshon situata duke qenë se shtyllat me fonde kanë filluar qysh tani t'i prekin punonjësit që dalin në pension tani. Por edhe në këto raste, ka një pakicë anëtarësh të planeve të cilën preken. Për shembull, në rastin e Kilit, i cili është vendi me shtyllën më të vjetër me fonde, vetëm 5% të anëtarëve të skemës u duhet të dalin në pension 5 vitet e ardhshme dhe shumë vende të tjera kanë një përqindje shumë më të ulët.

Krahas kësaj, disa sisteme me fonde kanë krijuar portofole që përfshijnë mundësi konservative që investohen kryesisht në borxh shtetëror afatshkurtër. Edhe pse këta portofole ofrojnë një normë kthimi relativisht të ulët, ata i mbrojnë anëtarët e skemës nga shumica e humbjeve të vlerave të asetëve. Në Kili, i cili i futi fondet e shumëfishta në vitin 2002, punonjësit me moshë më të madhe janë të kufizuar me fonde më konservative njëri prej të cilëve është një zgjedhje automatike nëse nuk zgjedhin diçka tjetër. Për pasojë, 80% e anëtarëve që janë nën 5 vjet larg moshës së daljes në pension, janë të investuar në njërin prej dy portofoleve më konservativë dhe janë kryesisht të mbrojtur nga humbjet. Por, edhe pse në numër të vogël, nëse këta punonjës që dalin në pension preken rëndë, kjo do të ketë një ndikim të ndjeshëm në mënyrën se si do perceptohen pensionet e reformuara dhe një ndikim politik që shkon përtej efektit ekonomik dhe, kështu, ka mundësi të ketë nevojë të trajtohet në njëfarë mënyre.

Vijon në numrin tjetër...

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, V. Theodhori, T. Cani,
Dh. Hazbiu, R. Eltari, E. Kokona

